

V E N D I M  
Nr.173, datë 7.3.2003

PËR EMËRIMIN, LIRIMIN OSE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DREJTUESVE TË  
INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, KRYEMINISTRIT OSE  
TË MINISTRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Drejtuesit e institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra, përkatësisht nga Kryeministri ose ministri përkatës, në rast se dispozita të tjera, të veçanta, ligjore dhe nënligjore, nuk parashikojnë ndryshe.
2. Emërimi i drejtuesve të institucioneve të treguara në pikën 1 bëhet sipas kërkesave dhe procedurave të mëposhtme:
  - Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë.
  - Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë.Kryeministri ose ministri përkatës përzgjedh dhe emëron njëjën nga kandidaturat e paraqitura që plotëson kërkesat e mësipërme.
3. Lirimi ose shkarkimi i drejtuesve të institucioneve të treguara në pikën 1, duhet të jetë i motivuar, pasi të jenë dëgjuar edhe pretendimet e personit.
4. Kur në dispozita të tjera, të veçanta, ligjore dhe nënligjore, është përcaktuar organi i emërtesës për drejtuesit e institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit, por nuk përcaktohen kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirimin ose shkarkimin e tyre, në këto raste zbatohen pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi.
5. Kur në dispozita të veçanta, ligjore dhe nënligjore, përcaktohet se drejtuesi i institucionit, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit, emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, por që nuk janë parashikuar kërkesat dhe procedurat për emërimin, lirimin ose shkarkimin e tyre, zbatohen kërkesat dhe procedurat e mëposhtme:
  - Procedura e emërimit, lirimit ose shkarkimit fillon nga Kryeministri ose ministri përkatës, sipas varësisë së institucionit.
  - Kryeministri ose ministri përkatës urdhërojnë, të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë.
  - Kandidatët e paraqitur duhet të përmbushin, krahas kërkesave të përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë.
  - Kryeministri ose ministri përkatës i propozojnë Këshillit të Ministrave jo më shumë se tri nga kandidaturat e paraqitura, që plotësojnë kërkesat e mësipërme.
  - Këshilli i Ministrave përzgjedh dhe vendos, me shumicën e anëtarëve, emërimin e njërit prej kandidatëve.
  - Propozimi i lirimit ose shkarkimit duhet të jetë i motivuar, pasi të jenë dëgjuar pretendimet e personit.
  - Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e vet të parë, merr vendimin për propozimin e lirimit ose të shkarkimit.

6. Vendimi nr.469, datë 14.8.1995, i Këshillit të Ministrave “Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe ndryshimet në strukturat e tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano